UDHËZIM
Nr. 6, datë 15.6.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 28.3.2012 "PËR EKZAMINIMIN E MJETEVE DHE PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATËS SË MIRATIMIT ADR"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, neneve 57 dhe 63 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar; ligjit nr. 9272, datë 16.9.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)" dhe protokollin e nënshkrimit", dhe kapitullit IX të urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 21.8.1998 "Për rregullat e klasifikimit, emërtimit dhe transportit rrugor të mallrave të rrezikshme", Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 5, datë 28.3.2012 "Për ekzaminimin e mjeteve dhe procedurat për lëshimin e certifikatës së miratimit ADR" bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Paragrafi 1 i nenit 4 ndryshon si më poshtë:

"1. Pronari i mjetit të plotë ose të plotësuar, i cili operon në transportin e mallrave të rrezikshme, aplikon për certifikatën e miratimit ADR të mjetit në Drejtorinë e Regjistrimit dhe të Licencimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).".

Neni 2

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "b" e paragrafit 1 riformulohet si më poshtë:

"b) dorëzon një kopje të certifikatës së lëshuar sipas shkronjës "a" të këtij paragrafi në Drejtorinë e Regjistrimit të Mjeteve dhe të Licencimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).".

2. Paragrafi 3 riformulohet si më poshtë:

"3 Certifikata e miratimit ADR e lëshuar sipas shkronjës "a" të paragrafit 1 ose raporti i lëshuar sipas paragrafit 2 të këtij neni firmosen nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) ose i autorizuari prej tij.".

Neni 3

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi 2 riformulohet si më poshtë:

"2. Data e fundit për të kryer një ekzaminim të mjetit sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 4 është 15 ditë nga data e dorëzimit të dokumentacionit në Drejtorinë e Regjistrimit të Mjeteve dhe të Licencimeve të DPSHTRR-së.".

2. Paragrafi 3 riformulohet si më poshtë:

"3. Kur një ekzaminim i mjetit sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 4 nuk është kryer në datën e fundit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, ekzaminuesi i autorizuar duhet të kthejë dokumentacionin, përfshirë certifikatën e miratimit ADR të mjetit te Drejtoria e Regjistrimit të Mjeteve dhe e Licencimeve të DPSHTRR-së, sipas paragrafit 3 të nenit 4 jo më vonë se 5 ditë nga data e fundit.".

Neni 4

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi